

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE DPAP 2023

Tërë-mujori i dytë

Nr. Rendor	Data	Kërkesa	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	06.04.2023	<p>1. Sa është numri dhe grupmosha e fëmijëve me autizëm, sindromën Doën, ADHD, me vështirësi në të nxënë, të cilët frekuentojnë shkollat publike dhe jo publike në vend, në CU, AMU dhe AML, sipas qarqeve dhe bashkive?</p> <p>2. Sa është numri i mësuesve mbështetës të angazhuar në shkollat publike në vend, sipas qarqeve?</p> <p>3. Cili është profili, arsimimi, i mësuesve mbështetës?</p> <p>4. A ka një plan/program për trajnimin në vijimësi të mësuesve mbështetës? Trajnimet ofrohen nga institucione publike apo subjekte të së drejtës private? Për trajnimet e ofruara nga subjektet private, cilat janë këto subjekte?</p> <p>5. Sa orë në ditë përfiton një fëmijë mbështetje nga mësuesi mbështetës?</p> <p>6. A ka informacion zyrtar lidhur me numrin e mësuesve mbështetës në kopshte/shkollat të punësuar privatisht nga familjet e fëmijëve, të specifikuar në pikën 1, dhe cilat janë kriteret për punësimin e tyre, kriteret që duhet të mbahen parasysh nga familja?</p> <p>7. Në kuadër të arsimit gjithëpërfshirës, a ka një strategji, plan veprimi, mekanizma ligjorë për fëmijët, sipas parashikimeve në pikën 1, për të frekuentuar kopshtet/shkollat në rastet kur aftësitë e veçanta të tyre nuk e mundësojnë një gjë të tillë? Nëse ka, a është e buxhetuar strategjia dhe cilat janë partneret.</p> <p>8. Sa i mundur është aksesimi i kopshteve/shkollave në aspekt të infrastrukturës, për fëmijët me probleme motorike (për shembull rasti i fëmijëve me karrige me rrota)?</p> <p>9. A janë të trajnuar mësuesit klasor dhe mësuesit mbështetës në lidhje me menaxhimin e shtyllës, teknikat dhe strategjitë?</p>	20.04.2023	<p>Bazuar në Urdhrin nr.31, datë 28.01.2020, "Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore publike të arsimit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar në fillim të vitit shkollor ngrënë Komisionin Multidisiplinar (KMD) të përbërë prej pesë anëtarësh, i cili me kërkesën e personit që ushtron përgjegjësinë prindërore vlerëson nevojat arsimore të fëmijëve dhe përcjellë me shkresë zyrtare rekomandimet e nevojshme për të realizuar procesin mësimor-edukativ në shkollë. KMD i rekomandon institucionit arsimor dhe prindit, llojin e arsimit më të përshtatshëm për t'u ndjekur nga nxënësi sipas nevojave që ai paraqet, nevojën e ndjekjes me mësues ndihmës, numrin e orëve që do të asistohet prej mësuesit ndihmës, si edhe rekomandimet përkatëse për hartimin e planit PEI.</p> <p>Të dhënat për numrin e nxënësve sipas diagnozave janë pjesë e punës së KMD-së dhe përpunohen në mënyrë konfidenciale nga ana e tyre.</p> <p>Në udhëzimin nr.26, datë 25.11.2019, "Për mësuesin ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar" është përcaktuar se një mësues ndihmës mund të punojë me 2-3 nxënës me aftësi të kufizuara, sipas rekomandimeve të KMD-së, bazuar në</p>	E plotë	jo
2	27.04.2023	<p>1. Sa persona që i përkasin Minoritetit Rom dhe Egjiptian janë punësuar në institucione shkollore publike sipas "Planit Kombëtarë të veprimit për Pakicave Rome dhe Egjiptian ?</p> <p>2. Ku shkolla janë punësuar, emrat e shkollës dhe qytetet ?</p> <p>3. Në harkun vjetor 2014-2023 sa persona janë punësuar sipas Planit Kombëtarë të veprimit për Pakicave Rome dhe Egjiptian ?</p>	08.05.2023	Percjelle tabela me te dhenat e kerkuara	e plotë	jo
3	02.05.2023	<p>Për t'i ardhur në ndihmë informacionit të saktë publik, në bazë të ligjit nr.119/2014 neni 15 pika 1 dhe 2 (Për të Drejtën e Informimit), redaksia e emisionit "Fiks Fare" në televizionin "Top Channel", kërkon nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, intervistë, informacion ose dokumente për studentët që kanë përfunduar bachelor në Universitetin Aleksandër Moisiu në Durrës, për degën "Gjuhë Letërsi dhe Anglisht".</p> <p>- Në redaksinë e emisionit Fiks Fare iu drejtua një ish-studente e Universitetit Aleksandër Moisiu në Durrës, e cila kishte përfunduar në atë universitet degën "Gjuhë Letërsi dhe Anglisht". Studentja Rovena Ndriccim Kurti ka marrë diplomën e bachelor. Më pas ka bërë Master Profesional në Universitetin privat "Beder" për degën "Mësuesi, Gjuhë Angleze për Arsimin e Mesëm". Ka bërë stazhin në Kurbin, ku është pajisur me certifikatën nga Zyra Arsimore Kurbin. Me këto diploma dhe këtë certifikatë ka aplikuar në Qendrën e Shërbimeve Arsimor (QSHA) për të marrë licensën. Pasi ka bërë pagesën përkatëse për provimin, është nxjerrë nga provimi nga punonjësi e QSHA-së me arsyetimin se diploma bachelor dhe ajo master profesional nuk përputhen me njëra-tjetrën. Disa studentë me të tilla probleme i janë drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe kanë marrë zgjidhje. Të tjerë, si rasti i Rovenës, janë në pritje, pasi kanë bërë kërkesë dhe janë në pritje të një zgjidhje të këtij rasti.</p> <p>- Cfarë hapash të tjerë duhet të bëjë e diplomuara për të marrë licensën të QSHA?</p> <p>- A ka një praktikë për këta studentë Ministria e Arsimit për t'i licensuar?</p>	16.05.2023	<p>Ne perqijete te kerkeses tuaj si edhe te kerkeses date 20.04.2023, depozituar ne Ministrine e Arsimit dhe Sportit dhe protokolluar me nr. 2612 prot., date 20.04.2023, me ane te se ciles znj. Rovena Kurti kerkon te pranohet per te marrë pjesë ne provimin e shtetit për profesionin e rregulluar të mësuesit.</p> <p>Referuar dokumentacionit bashkëlidhur kërkesës, rezultoni që znj. Rovena Kurti është pajisur me Diplomë "Bachelor" në "Gjuhë- Letërsi- Anglisht" nga Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës, si dhe Diplomë "Master Profesional" në "Mësuesi, Gjuhë Angleze për Arsimin e Mesëm nga Kolegji Universitar "Beder". Gjithashtu, znj. Kurti ka kryer me sukses praktikën profesionale në zbatim të pikës 5, të nenit 57, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe ka bërë pagesën e tarifës së provimit të shtetit, por nuk është pranuar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore për të marrë pjesë në provimin e shtetit.</p> <p>Bazuar në pikën 3, të nenit 57, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe pikës 2, të nenit 83, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë i mundësonet e drejta për t'u arsimuar. Për përbushjen e kësaj të drejte i ofrohet akses dhe kurrikulë mësimore. Fëmijët e humbur, të cilët rigjehen, kanë mundësi të ndjekin shkollat e zakonshme të arsimit parauniversitar, në të cilat mund të vijojnë procesin mësimor. Për të plotësuar orët e humbura, shkollat kanë detyrimin të zhvillojnë punë të diferencuar ose programe mësimore individuale me këto fëmijë, me qëllim që të marrin njohuritë dhe aftësitë mësimore të domosdoshme. Përveç kësaj zgjidhjeje, ata mund të ndjekin shkollat me kohë të pjesshme ose klasat e Shansit të Dytë. Agjencia e Sigurimit të Cilësisë ka hartuar https://www.ascap.edu.al/):</p> <p>- Plane dhe programe mësimore për shkollat me kohë të pjesshme (të arsimit bazë dhe të mesëm). Në shkollat e arsimit bazë me kohë të pjesshme kanë të drejtë të regjistrohen fëmijët që kanë mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç dhe nuk e kanë përfunduar arsimin bazë me kohë të plotë.</p> <p>- Plane dhe programe mësimore për klasat e Shansit të Dytë. Fëmijët e moshës së detyrimit shkollor që kanë braktisur shkollën, e ndërpresin ose nuk e kanë ndjekur dhe nuk lthehen në shkollën bazë me kohë të plotë dhe as ndjekin shkollën bazë me kohë të pjesshme, kanë të drejtë të ndjekin shkollimin e riuajtur Shansi i</p>	e plotë	jo
4	09.05.2023	<p>1.A ka shteti shqiptar kurrikula arsimore për fëmijët e regjistruar si të humbur, të cilët më pas janë rigjetur?</p> <p>2.Si ndodh rehabilitimi i këtyre të miturve në mbajtjet shkollore?</p> <p>3.A marrin këta fëmijë shërbim psikologjik falas?</p>	18.05.2023	<p>1. A ka shteti shqiptar kurrikula arsimore për fëmijët e regjistruar si të humbur, të cilët më pas janë rigjetur?</p> <p>2. Si ndodh rehabilitimi i këtyre të miturve në mbajtjet shkollore?</p> <p>3. A marrin këta fëmijë shërbim psikologjik falas?</p>	e plote	jo

5	17.05.2023	<p>*Sa konflikte me në qendër nxënës të shkollave 9-vjeçare apo të shkollave të mesme janë raportuar gjatë viteve 2022 dhe 2023 (deri më tani) në shkollë apo në ambientet përreth shkollave?</p> <ul style="list-style-type: none"> Cila drejtori arsimore ka pasur më shumë raportime të kësaj natyre në periudhën e sipërcituar? <p>*Cilat janë shkollat konkrete me më shumë raste të raportuara të konflikteve mes nxënësve në të gjithë vendin?</p> <p>*Sa shkolla në Republikën e Shqipërisë kanë oficerë të sigurisë? Cili është roli i tyre në shkolla?</p> <p>*Sa është numri i shkollave publike dhe jo-publike në të gjithë republikën?</p> <p>*Sa punonjës psikosocialë ka në të gjithë shkollat publike në vend? Sa ka qenë ky numër në vitin 2022 dhe sa është tani në 2023?</p> <p>*Sa i përket shkollave jo-publike, a ka parametra të sigurisë për të cilat ministria apo institucionet në varësi kontrollojnë? Cilat janë këto?</p> <p>*Duke u nisur tek rasti më i fundit në Gramsh të një konfliktit i cili rezultoi fatal midis dy nxënësve, në rastet kur një nxënës lë orën e mësimi, çfarë masash duhen marrë për nxënësit, a njoftohen prindërit? A ka ndodhur në rastin konkret? Ka një procedurë në këto raste?</p>	31.05.2023	<p>Gjatë vitit shkollorë 2022-2023 në shkollat ku ka të dislokuar oficerë sigurie janë raportuar 480 incidente të natyrave të ndryshme me në qendër nxënësit. Ndërsa konflikte fizike (dhunë fizike) në këto shkolla janë raportuar 188 raste të tilla.</p> <ul style="list-style-type: none"> Cila drejtori arsimore ka pasur më shumë raportime të kësaj natyre në periudhën e sipërcituar? Cilat janë shkollat konkrete me më shumë raste të raportuara të konflikteve mes nxënësve në të gjithë vendin? <p>Zyra Vendore Arsimore Tiranë dhe Kamzë janë ZVA-të që kanë numrin më të lartë të raportimeve të incidenteve nga shkollat për vitin shkollor 2022-2023, përkatësisht 100 raste ZVA Tiranë dhe 40 ZVA Kamzë. Theksojmë këto janë të dhëna vetëm nga shkollat që kanë oficerë sigurie në strukturën e tyre.</p> <ul style="list-style-type: none"> Sa shkolla në Republikën e Shqipërisë kanë oficerë të sigurisë? Cili është roli i tyre në shkolla? Në Republikën e Shqipërisë 220 institucione arsimore kanë në përbërje të strukturës së tyre oficerë sigurie. Roli i oficerit të sigurisë në shkolla: <ul style="list-style-type: none"> Monitoron mjedisin e shkollës në mënyrë të vazhdueshme, rreth të situatave të dyshimta, hyrjes së personave të paautorizuar apo penimit të pronës së shkollës. Ofron një prani të dukshme dhe të aksesueshme brenda shkollave dhe më tej në komunitet 	e plote	jo
6	02.06.2023	<ol style="list-style-type: none"> Sa është numri i mësuesve të angazhuar në mbikqyrjen e mbarëvajtjes së procesit të organizimit të provimeve të maturës? A janë paguar këta mësues shtesë? Nëse po, sa ? Sa është numri i mësuesve të angazhuar në mbikqyrjen e mbarëvajtjes së procesit të organizimit të provimeve të lirimt? A janë paguar këta mësues shtesë? Nëse po, sa ? Sa është numri i maturantëve për vitin akademik 2022-2023? Sa prej tyre kanë marrë pjesë në realizimin e provimeve? 	13.06.2023	<p>Gjithsej do të angazhohen rreth 3500 punonjës arsimorë, për secilin provim.</p> <p>Të gjithë mësuesit e angazhuar në organizimin, mbikqyrjen dhe mbarëvajtje e provimeve të maturës shtetërore janë pjesë e sistemit arsimor parauniversitar dhe provimi zhvillohet brenda orarit zyrtar të punës si rrjedhojë për këtë proces nuk ka page shtesë.</p> <p>Bazuar në Udhëzimin nr. 5, datë 17.02.2023 "Për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë në Republikën e Shqipërisë, viti shkollor 2022-2023" provimet kombëtare të arsimit bazë do të zhvillohen nga data 20.06.2023-26.06.2023.</p> <p>Nuk ka mësues shtesë të përfshirë në organizimin, mbikqyrjen dhe mbarëvajtjen e procesit të zhvillimit të provimeve kombëtare të arsimit bazë.</p> <p>Numri i maturantëve të regjistruar për maturën shtetërore është rreth 28000 nxënës, pasi në lëndë të ndryshme ka dhe regjistrime AIZ(nxënës të mbartur nga vite të kaluara)</p> <p>Në provimin e parë, "Gjuhës e huaj", që u zhvillua me datë 1 qershor 2023, nga 27732 maturantë morën pjesë 27236, ose 98 % e tyre.</p> <p>Në provimin e dytë "Gjuhë shqipe dhe letërsi" (D1), që u zhvillua me datë 7 qershor 2023 nga 27767</p> <p>Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion statistikor për shkollën 9-vjeçare "Halit Coka", Bathore, ju bëjmë me dije se:</p> <p>Sa ka qenë numri total i nxënësve në shkollën "Halit Coka" në 3 vitet e fundit? (statistika të ndara sipas viteve).</p> <p>oPër vitin shkollor 2020-2021 numri i nxënësve ishte 1027 nxënës</p> <p>oPër vitin shkollor 2021-2022 numri i nxënësve ishte 1040 nxënës</p> <p>oPër vitin shkollor 2022-2023 numri i nxënësve është 990 nxënës. Gjate këtyre viteve vetëm në vitin shkollor 2021-2022 ka patur 1 nxënës të klasës së nëntë i cili nuk ka vijuar frekuentimin e shkollës për shkak të problemeve sociale në familje.</p> <p>Gjate 2 viteve shkollore, përkatësisht 2020-2021 dhe 2021-2022 numri i klasave mësimore nuk ka ndryshuar. Gjate vitit shkollor 2022-2023 është mbyllur një klasë e nëntë.</p> <p>Lidhur me parashikimet në udhëzimin nr. 12, datë 10.6.2021, i ndryshuar llojet e veprave penale janë vlerësuar rast pas rasti. Informojmë se parashikimet e pikës 4/1, përcautojnë se "4/1. Nuk mund të aplikojnë për konkurrim, për të punuar si mësues, pavarësisht faktit të rehabilitimit, të gjithë personat që: a) janë dënuar nga gjykata me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale kundrejt të miturve; b) janë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, që lidhet me institucionet arsimore".</p> <p>Këto vepra penale në varësi të objektit të veprës penale, dhe marrëdhëniet shoqërore që vetë vepra penale synon të mbrojë, siç janë të miturit apo institucionet arsimore.</p> <p>Në parlament është miratuar në seancën plenare të datës 15.5.2023 projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar në të cilin është parashikuar shtimi i një neni të posaçëm që parashikon si vijon:</p> <p>Neni 60/1</p> <p>Ndalimi për të punuar në sistemin arsimor parauniversitar Punonjësi arsimor, si dhe çdo punonjës tjetër i sistemit arsimor, që punon me fëmijët, nuk mund</p>	e plote	jo
7	05.06.2023	<p>Report Tv kërkon të marr informacion sa është numri i nxënësve të shkollës 9-vjeçare 'Halit Coka' në Bathore?</p> <p>-Sa ka qenë numri total i nxënësve në shkollën 'Halit Coka' në 3 vitet e fundit (statistika të ndara)?</p> <p>-Sa nxënës kanë braktisur shkollën dhe për çfarë arsyesh?</p> <p>-A ka klasa të mbyllura ?</p>	15.06.2023	<p>Në bazë të nenet 3, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", duke qenë se nuk ka asnjë përkufizim në ligjin nr. 69/2012 dhe Udhëzimin nr. 12/2021, kërkoj të njihem me aktin në fjalë që bën përkufizimin se cilat janë këto vepra penale?</p> <p>Në të kundërt, nëse nuk ka asnjë përcaktim të tillë në legjislacionin për arsimin e lartë, por dispozita referon tek Kodi Penal, kërkoj të informohem mbi dispozitat përkatëse juridiko-penale që përbëjnë kusht ndalues për të ushtruar profesionin e mësuesit?</p>	e plote	jo
8	09.06.2023	<p>Ligji nr. 69/2012 dhe Udhëzimi nr. 12, datë 10.6.2021, përcautojnë se "4/1. Nuk mund të aplikojnë për konkurrim, për të punuar si mësues, pavarësisht faktit të rehabilitimit, të gjithë personat që: a) janë dënuar nga gjykata me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale kundrejt të miturve; b) janë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, që lidhet me institucionet arsimore".</p> <p>Në bazë të nenet 3, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", duke qenë se nuk ka asnjë përkufizim në ligjin nr. 69/2012 dhe Udhëzimin nr. 12/2021, kërkoj të njihem me aktin në fjalë që bën përkufizimin se cilat janë këto vepra penale?</p> <p>Në të kundërt, nëse nuk ka asnjë përcaktim të tillë në legjislacionin për arsimin e lartë, por dispozita referon tek Kodi Penal, kërkoj të informohem mbi dispozitat përkatëse juridiko-penale që përbëjnë kusht ndalues për të ushtruar profesionin e mësuesit?</p>	20.06.2023	<p>Lidhur me parashikimet në udhëzimin nr. 12, datë 10.6.2021, i ndryshuar llojet e veprave penale janë vlerësuar rast pas rasti. Informojmë se parashikimet e pikës 4/1, përcautojnë se "4/1. Nuk mund të aplikojnë për konkurrim, për të punuar si mësues, pavarësisht faktit të rehabilitimit, të gjithë personat që: a) janë dënuar nga gjykata me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale kundrejt të miturve; b) janë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, që lidhet me institucionet arsimore".</p> <p>Këto vepra penale në varësi të objektit të veprës penale, dhe marrëdhëniet shoqërore që vetë vepra penale synon të mbrojë, siç janë të miturit apo institucionet arsimore.</p> <p>Në parlament është miratuar në seancën plenare të datës 15.5.2023 projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar në të cilin është parashikuar shtimi i një neni të posaçëm që parashikon si vijon:</p> <p>Neni 60/1</p> <p>Ndalimi për të punuar në sistemin arsimor parauniversitar Punonjësi arsimor, si dhe çdo punonjës tjetër i sistemit arsimor, që punon me fëmijët, nuk mund</p>	e plote	jo

9	16.06.2023	<p>1.A kanë marrë trajnime për mënyrën e ndërfaqes me nxënësit mësuesit e angazhuar në organizimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtje e provimeve të maturës shtetërore?</p> <p>2.Sa mësues janë angazhuar në hartimin e tezave të maturës?</p> <p>3.Sa ka qenë numri i mësuesve-hartues për secilin provim?</p> <p>4.Sa është numri i nxënësve të kapur me kopje ne 3 provimet e para të maturës shtetërore?</p> <p>5.Cilat janë masat e marra ndaj tyre? Sa prej tyre do e ripërsërisin provimin?</p> <p>6.Si ruhet sekreti i provimeve te maturës deri në momentin e arritjes në shkolla?</p> <p>7.Në çfarë kushtesh punojnë hartuesit e tezave të maturës për të siguruar mospublikimin e provimeve më herët se hyrja në provim e nxënësve?</p> <p>8.Sa është numri i rasteve ku tezat e maturës kanë dalë përpara nisjes së zhvillimit të tezës?</p> <p>9.Cilat janë personat përgjegjës për publikimin parakohe të tezës?</p> <p>10.Cilat janë masat që ka marrë MAS për mospërsëritjen e këtyre rasteve?</p> <p>11.Cilat janë masat e marra ndaj individëve që kanë publikuar tezat?</p>	23.06.2023	<p>Po, të gjithë mësuesit që do të ishin të angazhuar në Maturën Shtetërore 2023, në zbatim të Urdhrit të përbashkët nr. 739 datë 15.12.2022 për miratimin e Rregullores për zhvillimin e Maturës Shtetërore në Republikën e Shqipërisë", neni 7, "Detyrat e KMSH në ZVAP", pika 12, ku citohe që ZVAP ka detyrë të trajnojë përgjegjësit e administrimit të provimit(PAP), përgjegjësit e katit(PK), administratorët e provimit(AP) dhe administratorët e sekretimit(AS) të testeve të Maturës Shtetërore, drejtuesit e shkollave ku do të zhvillohen provimet e MSH 2023 (DSHK), secila ZVAP ka hartuar kalendarin e trajnimit të tyre, mbi rregulloren e MSH 2023 për të gjithë aktorët pjesëmarrës në këtë proces. Në zbatim të kalendarit të trajnimeve janë zhvilluar të gjitha këto trajnime. Në provimet e MSH 2023, për përgatitjen e fondit të pyetjeve janë angazhuar 60 mësues. Sa ka qenë numri i mësuesve-hartues për secilin provim?</p> <p>Për secilin provim të MSH 2023, për hartimin e fondit të pyetjeve janë angazhuar sa më poshtë:</p> <p>Për lëndën "gjuhë e huaj" (D3): 20;</p> <p>Për lëndën "gjuhë shqipe dhe letërsi" (D1): 5;</p> <p>Për lëndën "gjuhë shqipe dhe letërsi" (D2): 5;</p> <p>Për provimin e lëndës me zgjedhje (Z): 30;</p> <p>Në tri provimet e para nuk ka matur nxënës të kapur me</p>	e plotë	jo
---	------------	---	------------	--	---------	----